



**ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVA**

Prishtinë, Gusht 2017

Deklaratë Politike

Bazuar në Deklaratën Politike të miratuar në Kuvendin e Gjashtë Zgjedhor të mbajtur më 4 maj 2013, duke u nisur nga traditat civilizuese të popullit të Kosovës dhe vlerat historike të demokracive evropiane, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) konfirmon orientimin e saj si parti e qendrës së djathtë, të mbështetur në demokracinë shumëpartiake, ekonominë e tregut, sundimin e ligjit dhe traditave shekullore të popullit shqiptar të Kosovës.

AAK i jep prioritet të lartë konsolidimit të shtetit dhe të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës me theks të veçantë integrimin e tërë qytetarëve të Republikës së Kosovës në një sistem të vetëm politik, juridik dhe publik.

AAK mbështet ekonominë e tregut të bazuar në pronësinë dhe iniciativën private. AAK e promovon fuqishëm zhvillimin e mëtejme të sektorit privat të ekonomisë, i cili do të jetë i bazuar në iniciativën e lirë dhe në ndërmarrësinë e njerëzve të Kosovës.

AAK është e vendosur në zhvillimin e demokracisë në Kosovë, institucioneve efikase demokratike, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, mediat e lira dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe ndërkombëtare.